

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6451
E premte, 29 tetor 2021
çmimi 0.40 €

Norvegjia përkrah
shoqërinë civile në Kosovë
me 170 000 euro IFAGE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE PËR RAUNDIN E PARË TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË 17 TETORIT

SHPALLEN REZULTATET PËRFUNDIMTARE, 21 KOMUNA NË BALOTAZH



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka shpallur rezultatet përfundimtare për raundin e parë të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit. Sipas këtij rezultati, 21 komuna do të garojnë në raundin e dytë në balotazh, ndërsa në 17 komuna është vendosur fituesi në raundin e parë. Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, në afat brenda 24-orësh, subjektet politike dhe kandidatët mund t'i paraqesin ankesat e tyre në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) IFAGE 8

AVOKATI I GUCATIT DHE I HARADINAJT: TË PËRJASHTOHET DËSHMIA E HETUESES SË ZPS-së IFAGE 7



EKIPE MOBILE PËR VAKSINIM NË SHTATË QYTETE TË KOSOVËS IFAGE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepgjisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



KËRCËNOHET KRYEMINISTRI
KURTI, RRIKET NIVELI I SIGURISË
PËR TË F. 7

KEDS-i DHE ODA EKONOMIKE
DISKUTOJNË RRETH KRIZËS
ENERGJETIKE F. 3

KDI-JA KËRKON NGA KOMUNA E
PEJËS ZBATIMIN E LIGJIT PËR
QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE F. 6

EKONOMI



QEVERIA SUBVENCIONON KREDITË
E BIZNESEVE PRODHUESE F. 8

PROTESTOJNË PUNËTORËT
E KOMPANISË "FERONIKEL"-i F. 8

SPORT



SHABANI: GJILANI
DO TË RIKTHEHET
DUARBOSH NGA KLINA F.10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama: "Open Balkan" është e ardhmja, bashkimi i shqiptarëve bëhet me mjetet e së ardhmes



TIRANË, 28 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ideja e "Open Balkan"-it është e ardhmja dhe se bashkimi i shqiptarëve ndodh vetëm me mjete të së ardhmes dhe jo me "avazin e vjetër". Kështu i është përgjigjur kryeministri i Shqipërisë një komentuesi në "Facebook", i cili i ka thënë Ramës se nuk pajtohet vetëm në një pikë, atë të idesë për "Open Balkan". "Jetë të gjatë, o

kryeministër! Me të gjitha politikat e tua pajtohem përveç një (jo 'Open Balkan'). Shqiptarët kanë nevojë për bashkim, kështu që serbët nuk i duam as në det e as në territorin tonë", ka shkruar ky komentues. Derisa Rama i është kundërpërgjigjur duke i thënë se të gjithë ata që kthejnë akrepat e orës mbrapsht e gënjejnë veten. "Ora e historisë shkon përpara dhe kush ia tërheq akrepat

mbrapsht thjesht gënjen veten. 'Open Balkan' është e ardhmja dhe bashkimi i shqiptarëve bëhet me mjetet e të ardhmes, jo me avazin e vjetër të së shkuarës. Sa për detin, duhet të jemi shumë të qetë, se detin që na e ka dhënë Zoti nuk na e merr dot askush, por duhet të jemi edhe të mençur që edhe nga deti të krijojmë më shumë ekonomi e mirëqenie", ka shkruar Edi Rama.

Schmidt: Bosnja përbëhet nga entitetet, e tillë do të mbetet

SARAJEVË, 28 TETOR - Bosnje e Hercegovina përbëhet nga entitetet dhe e tillë do të mbetet, sepse ato janë pjesë e integritetit territorial, të përshkruar me Marrëveshjen e Dejtonit, ka theksuar përfaqësuesi i lartë ndërkombëtar në Bosnje, Christian Schmidt. Schmidt, i cili ka marrë detyrën në muajin gusht, iu drejtua të enjten për herë të parë Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Bosnjës. Ai ka thënë se është e qartë se "askush nuk ka interes ta kthejë kohën pas" dhe se "komuniteti ndërkombëtar nuk do të qëndrojë anash". Komentet vijnë pasi Republika

Sërpska e Bosnjës, entitet i banuar me shumicë serbe, ka kërcënuar me ndarje. Ky entitet, mes të tjerash, ka sfiduar Kushtetutën e Bosnjës me miratimin e një ligji për produktet dhe pajisjet mjekësore. Përfaqësuesit e tij kanë thënë, po ashtu, se serbët e Bosnjës do të tërhiqen nga ushtria e përbashkët e vendit. Përfaqësuesit e Republikës Sërpska nuk morën pjesë në seancën ku foli Schmidt. Ata janë duke e bojkotuar punën e institucioneve qendrore të Bosnjës që nga fundi i korrikut, kur paraardhësi i Schmidt, Valentin Inzko, ka vendosur një ligj që ndalon mohimin e gjenocidit dhe krimeve të tjera të



Valentin Inzko, ka vendosur një ligj që ndalon mohimin e gjenocidit dhe krimeve të tjera të

luftës. Republika Sërpska ka refuzuar ta ndalojë me ligj mohimin e

gjenocidit. Schmidt tha se qytetarët e Bosnjës meritojnë të ardhme paqësore dhe të begatë. "Ajo që ata nuk meritojnë është frika. Atmosfera e frikës dhe e ndarjes vetëm se do ta përshpejtojë largimin e të rinjve. Nuk kam mundur të pres në muajin gusht që Bosnja do të përballet me sfidën më serioze ndaj sovranitetit të saj", ka thënë ai. Republika Sërpska së bashku me Federatën Myslimane-Kroate janë dy entitetet që përbëjnë Bosnje e Hercegovinën. Organizimi i tillë është bërë me të ashtuquajturën Marrëveshje të Dejtonit, e cila i ka dhënë fund luftës në Bosnje në vitet 1990.

Vuçiq: Serbia mbështet politikën 'Një Kinë'



BEOGRAD, 28 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i tha ministrit të Punëve të Jashtme të Kinës, Wang Jiem, i cili ndodhet për vizitë dyditore në Serbi, se Beogradi e mbështet politikën "Një Kinë". "Faleminderit për mbështetjen e integritetit territorial të Serbisë! Ju po e bëni atë në të njëjtën mënyrë sikurse Serbia e cila mbështet politikën e një Kine", ka deklaruar Vuçiq. Sipas politikës "Një Kinë", Kina kontinentale dhe Tajvani janë pjesë të patjetërsueshme të Kinës së bashkuar.

Serbia, në anën tjetër, nuk e njeh pavarësinë e Kosovës e cila është shpallur në shkurt të vitit 2008. Vuçiqi tha se Serbia nuk ka çështje të hapura me Kinën në sferën politike dhe se të dyja vendet bashkëpunojnë shkëlqyeshëm në të gjitha institucionet dhe organizatat ndërkombëtare. "Miqësia jonë është e sinqertë, e madhe dhe nuk është çudi që shpesh e cilësojmë të çeliktë", ka deklaruar Vuçiq. Ai tha se fakti që Kina dhe Serbia e kanë trefishuar

shkëmbimin tregtar në pesë vjet, pasqyron më së miri marrëdhëniet e ndërsjella. Serbia është pjesë e nismës shtetërore kineze "Brezi dhe Rruga", së bashku me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Me këtë nismë është paraparë ndërtimi i tubacioneve, rrugëve dhe projekteve të tjera infrastrukturore. Ministri i Jashtëm kinez tha se zhvillimi i bashkëpunimit është në të mirë të qytetarëve të të dyja vendeve. "Ne jemi krenarë për zhvillimin e marrëdhënive tona", ka thënë Wangu.


Koronavirusi thyen rekorde në Rusi dhe Ukrainë

MOSKË, 28 TETOR - Rusia raportoi të enjten shifra rekorde të viktimitave dhe të të infektuarve me koronavirus. Sipas raportit zyrtar të qeverisë, në 24 orët e fundit u konfirmuan 1 159 të vdekur dhe 40 096 të infektuar. Me këto shifra, numri i përgjithshëm i viktimitave në

Rusi arrin mbi 235 000 dhe është i katërti më i lartë në botë, pas Shteteve të Bashkuara, Brazilit dhe Indisë. Nga e enjtja, Moska është futur në izolim të pjesshëm për shkak të situatës së rënduar pandemike. Vetëm dyqanet me shërbime esenciale, të tilla

si ushqimoret dhe farmacitë, lejohen të punojnë. Nga fundjava, ndërkaq, do të nisë java mbarëkombëtare e mospunës. Ukraina, po ashtu, raportoi për numër rekord të të infektuarve në 24 orët e fundit: 26 071. Shifra e tejkalon rekordin e

vendosur më 22 tetor prej 23 785 të infektuarish. Ministria e Shëndetësisë e Ukrainës ka njoftuar se në 24 orët e kaluara janë regjistruar 576 viktima nga koronavirusi. Numri i përgjithshëm i të infektuarve në Ukrainë është mbi 2.8 milionë, ndërsa i viktimitave 66 204. Rritje të



shkallës së infektimit ka në të gjithë Evropën Lindore dhe autoritetet kanë fajësuar për këtë shkallën e ulët të vaksinimit.

KEDS-i dhe Oda Ekonomike diskutojnë rreth krizës energjetike

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 TETOR - Kryeshefi ekzekutiv i KEDS-it, Alpin Dogan, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, me të cilin është diskutuar situata aktuale e furnizimit me energji elektrike, me fokus te bizneset.

Kriza energjetike e cila ka prekur edhe Ballkanin ka bërë që siguria e furnizimit me energji elektrike të jetë mjaft sfidë për institucionet që janë pjesë e hallkës zinxhore elektro-energjetike.

Kësisoj, KEDS-i është duke realizuar takime informuese ndërinstytucionale me aktorë të ndryshëm në vend, me qëllim që të gjendet zgjidhje për tejkalimin e kësaj krize.

Përgjatë takimit, kryeshefi i KEDS-it, Alpin Dogan, ka thënë se sa i përket anës së KEDS-it, janë bërë përgatitjet e nevojshme

për dimër, mirëpo sfidë do të jetë importi i energjisë që, sipas tij, çmimi ka arritur shifra rekorde në tregjet ndërkombëtare. "Sa i përket rrjetit elektrik, KEDS-i, si çdoherë, ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme në terren. Janë ndërmarrë veprime konkrete të cilat do të mundësojnë shpërndarje të mirëfilltë të energjisë deri te konsumatori. Mirëpo kriza energjetike sigurisht që ka prekur edhe Kosovën. Çmimi i importit të energjisë është shumëfishuar derisa furnizimi gjatë dimrit do të ndikohet nga shumë faktorë. Shfrytëzimi i energjisë për ngrohje dhe rritja e vazhdueshme e kërkesës për energji, rrjedhimisht nevoja për import më të lartë, do të jenë ndër sfidat kryesore këtë dimër", ka deklaruar Dogan.

Ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka shprehur gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar, në



mënyrë që kjo krizë të tejkalohet sa më lehtë dhe pa pasoja për bizneset. "Ne si Odë, gjatë kësaj kohe, do të jemi në koordinim të vazhdueshëm dhe komunikim të përditshëm me bizneset, për t'i informuar me rrjedhën e

furnizimit me energji elektrike, në mënyrë që ata sa më pak të afektohen në veprimtaritë që ushtrojnë", ka thënë Rukiqi.

Në përfundim të këtij takimi, KEDS-i dhe Oda Ekonomike e Kosovës u pajtuan që ta

vazhdojnë komunikimin e deritanishëm dhe bashkërisht edhe me institucionet e tjera që janë pjesë e hallkës energjetike, të shqyrtohen të gjitha propozimet dhe rekomandimet në mënyrë që kriza të tejkalohet me sukses.

Ushtarakët rezervë të Kosovës dhe Shqipërisë nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Shoqata e Ushtarakëve Rezervë të Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e parë të bashkëpunimit me Shoqatën Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë.

Të dyja palët janë pajtuar që të thellojnë më tej bashkëpunimin në mes tyre, me qëllim të ngritjes së gatishmërisë dhe kapaciteteve të forcave rezervë, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me synimin final anëtarësimin e Shoqatës së Ushtarakëve Rezervë të Kosovës në Konfederatën Ndërraleate të Oficerëve Rezervë (CIOR), me seli në Bruksel.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, presidenti i Shoqatës së Ushtarakëve Rezervë të Kosovës, nënkolonel Prindon Sadriu, ka falënderuar presidentin e Shoqatës Kombëtare të

Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë, kolonel Thoma Konduri, për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe për kontributin e dhënë për krijimin e urave të komunikimit me CIOR.

Gjithashtu, gjatë vizitës zyrtare në Shqipëri, delegacioni i Shoqatës së Ushtarakëve Rezervë të Kosovës zhvilloi takim të ndarë me zëvendësministren e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Dallëndyshe Bici. Kjo e fundit e ka njoftuar delegacionin nga Kosova për angazhimin dhe planet e Ministrisë së Mbrojtjes për rezervën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Ajo ka vlerësuar bashkëpunimin e frytshëm dhe vëllazëror mes dy shoqatave të oficerëve rezervë si dhe ofroi mbështetjen e saj për aktivitetet e përbashkëta dhe ato brenda CIOR-it.

Norvegjia përkrah shoqërinë civile në Kosovë me 170 000 euro

EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 28 TETOR - Gjashtë organizata kanë nënshkruar të enjten kontratat për grante, si përfutuese të thirrjes së tretë në programin e shoqërisë civile për Shqipëri dhe Kosovë, të përkrahur nga Norvegjia, dhe të zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Projektet e përkrahura kontribuojnë në fushat e mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore, mbrojtjen e mjedisit,

luftën kundër korrupsionit dhe përkrahjen e pakicave dhe grupeve të marginalizuara.

Totali i granteve të dhëna në këtë rreth të përkrahjes është rreth 170 000 euro, ndërsa përgjatë tre vjetëve të këtij programi Norvegjia ka ndarë afër 1.5 milion euro për 45 projekte të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë dhe Shqipëri.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit drejtoresha ekzekutiv në KCSF, Taulant Hoxha, ka theksuar se pas 20 vjetësh përkrahjeje nga partnerët ndërkombëtarë, tashmë shoqëria

civile në Kosovë ka arritur pjekuri të mjaftueshme për të synuar ndikim konkret në ndryshimin e jetëve të qytetarëve me të cilët punon.

Në anën tjetër, Henrik Width, zëvendësambasador nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, ka theksuar se Norvegjia është e lumtur që mund të kontribuojë në një shoqëri civile të fortë dhe të gjallë në Kosovë, e cila përmes ideve inovative e projekteve kreative do të ndihmojë edhe në avancimin e procesit të anëtarësimin të Kosovës në BE.





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE PËR RAUNDIN E PARË TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË 17 TETORIT

Shpallen rezultatet përfundimtare, 21 komuna në balotazh

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka shpallur rezultatet përfundimtare për raundin e parë të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit. Sipas këtij rezultati, 21 komuna do të garojnë në raundin e dytë në balotazh, ndërsa në 17 komuna është vendosur fituesi në raundin e parë. Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, në afat brenda 24 orësh, subjektet politike dhe kandidatët mund t'i paraqesin ankesat e tyre në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të enjten ka shpallur rezultatet përfundimtare për zgjedhjet lokale të 17 tetorit në Kosovë. Sipas këtyre rezultateve, 21 komuna do të garojnë në raundin e dytë në balotazh, ndërsa në 17 komuna është vendosur fituesi në raundin e parë.

Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, në afat brenda 24 orësh subjektet politike dhe kandidatët mund t'i paraqesin ankesat e tyre në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP).

Duke u mbështetur në këto rezultate, në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë në këto 21 komuna: Gjakovë, Glogoc (Drenas), Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë,

Kamenicë, Obiliq, Rahovec, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik, Mamushë dhe Kllokot. Ndërsa në raundin e parë të zgjedhjeve, 17 komuna kanë zgjedhur kryetarët e tyre.

Rezultati përfundimtar shpallet edhe për Hanin e Elezit

Në shpalljen e rezultateve përfundimtare është përfshirë edhe komuna e Hanit të Elezit, ndonëse rezultati për kryetar të kësaj komune ende është në proces gjyqësor nga organet kompetente për shkak se zgjedhjet në këtë komunë janë kontestuar nga kandidati i pavarur, Rufki Suma, i cili, sipas rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, është mundur nga kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Mehmet Ballazhi.

Kjo çështje ka nxitur debat në mbledhjen e KQZ-së.

Anëtari i Lëvizjes Vetëvendosje në këtë institucion, Halim Rama, e ka kundërshtuar shpalljen e rezultatit përfundimtar për këtë komunë. Ai ka bërë me dije se, bazuar në vendimin e PZAP-it, ka kohë që palët të ankohen në Supreme. "Ankesa është në proces e sipër. Unë nuk e pashë të arsyeshme për një komunë ku ankesa është në proces. Pjesa e ankesës kishte të bënte me zgjedhje", ka thënë Rama.

Ndërsa anëtari i PDK-së në KQZ, Arianit Elshani, është shprehur pro shpalljes së rezultatit edhe për Hanin e Elezit. "Nuk e di pse të mbahet kjo mbledhje. Ndoshta kemi mundur të presim ende për t'i shpallur rezultatet. Më duket tendencioze që kjo komunë të ndalet nga shpallja e rezultateve. Mendoj se vendimi paraprak i supremes edhe PZAP-it tashmë kanë betonuar këtë çështje dhe dyshimet që kanë qenë të pabaza, prandaj mendoj se rezultatet për Han të Elezit duhet të shpallen", ka thënë ai.

Për këtë çështje ka folur edhe kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi.

Në argumentimin e tij për shpalljen e rezultateve përfundimtare edhe për Hanin e Elezit, Radoniqi ka deklaruar se po bëjnë shpalljen e rezultateve e jo certifikimin e tyre. "PZAP-ja na ka

dërguar një shkresë që të mos shpallen rezultatet meqë ka ankesa. Nga Supreme kemi një shkresë ku thuhet se nuk mund të certifikohet rezultati për Han të Elezit. Mendoj se mund ta bëjmë shpalljen, por nëse nuk dëshironi ta shpallni këtë rezultat, atëherë jua lë juve", ka thënë ai.

Më pas ai këtë çështje e ka hedhur në votim, ku nëntë vota kanë qenë pro shpalljes së rezultatit përfundimtar edhe për komunën e Hanit të Elezit, ndërsa dy anëtarët e LV-së nuk kanë marrë pjesë në votim.

Suma ishte ankuar në PZAP duke kërkuar përsëritje të votimit për shkak të "presionit ndaj votuesve".

PZAP kishte marrë vendim për përsëritje të votimit në të gjithë Hanin e Elezit, mirëpo Gjykata Supreme kishte vendosur që kjo çështje të rivendoset në PZAP.

PZAP-ja në vendimin e dytë, të marrë më 28 tetor, hodhi poshtë kërkesën e Sumës për përsëritje të votimit. Aktualisht lidhur me këtë vendim po rrjedh ende afati për ankesë në Gjykatën Supreme.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet Lokale, raundi i dytë i zgjedhjeve ndërmjet dy kandidatëve, të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme, mbahet ditën e diel, katër javë pas raundit të parë. Në këtë rast i bie që raundi i dytë do të mbahet më 14 nëntor.

Kurti shpreson se edhe raundi i dytë i zgjedhjeve të shkojë mirë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se institucionet e Kosovës do të angazhohen që edhe raundi i dytë i zgjedhjeve të shkojë mirë. Ai ka deklaruar se partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, synon dhe dëshiron që të fitojë në komunat në të cilat do të garojë në balotazh më 14 nëntor. "Ne do të përpiqemi që gjithçka të shkojë në rregull

sa i përket procesit, pra të mos ketë incidente, të jenë zgjedhje demokratike e të lira, fer, pra të ndershme dhe si Qeveri e Kosovës jemi në mbështetje të të gjitha institucioneve, mekanizmat shtetërorë që do t'i organizojnë zgjedhje e, natyrisht, synojmë e dëshirojmë që të fitojmë", ka thënë Kurti.

Avokati i Gucatit dhe Haradinajt: Të përjashtohet dëshmia e hetueses së ZPS-së



HAGË, 28 TETOR - Pas përfundimit të dëgjimit të dëshmitares së parë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) në gjykimin ndaj ish-krerëve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, trupi gjykues ka dëgjuar parashtrimet e palëve lidhur me pranimin ose jo të deklaratave të dëshmitares si prova materiale.

Nga prokuroria është bërë përmbledhja e deklaratave të dëshmitares Zdenka Pumper, ndërsa mbrojtja ka deklaruar se dëshmia e hetueses së ZPS-së nuk duhet pranuar meqë, sipas tij, vlera prodhuese është më e vogël se efekti dëmtues.

Në seancën gjyqësore ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt në Dhomat e Specializuara në Hagë, prokurorja Valeria Bolici ka ritheksuar kërkesën e ZPS-së për pranimin e disa deklaratave të dëshmitares Pumper si prova materiale.

Duke përmendur deklaratat e hetueses Pumper, prokurorja ka thënë se klasifikimi i tyre është konfidencial meqë përbëjnë referenca konkrete në lidhje me përmbajtjen e materialeve konfidenciale. "Prova 'P00102' është e rëndësishme për arsyet që i përmendi dëshmitari 4841 në deklaratën e saj 'P89MFI'. Kjo është

një korrespondencë që e ka marrë ZPS-ja që përfshinë edhe fotografi të faqeve nga dokumentet nga paketat 1 dhe 4 të marra nga ZPS-ja nga një shtëpi e mediave. Si i tillë dokumenti mbështet faktin e shpërndarjes së informacionit konfidencial nga ana e të akuzuarave më 7 shtator brenda konferencës së shtypit. Dokumenti 'P001' dhe nota zyrtare e ZPS-së që flet për origjinën e korrespondencës konfirmojnë autenticitetin e kësaj. Autenticiteti i 'P00102' është trajtuar edhe nga dëshmitari '4841' gjatë dëshmisë, ZPS-ja parashtron se këto dokumente duhet të mbeten konfidenciale meqë përmbajnë konferenca ndaj identitetit të palëve të treta dhe për këtë arsye mund të ndikojnë në të drejtën e privatësisë si dhe ta zbulojnë identitetin e pjesëtarëve të ZPS-së", ka thënë prokurorja Bolici.

Ajo ka thënë se të gjitha faqet e nxjerra nga paketa 2, autenticiteti i tyre është vërtetuar nga dëshmitarja dhe janë dokumente të marra nga OVL-UÇK më 17 shtator 2020 dhe, sipas saj, përbëjnë prova materiale. Ndërsa gjykatësi Fergal. M. Gejnor ka thënë se gjyqi është publik andaj provat materiale të pranuar duhet të jenë të qasshme nga

publiku. "Gjyqi është gjyq publik, të akuzuarit kanë të drejtë të kenë një gjyq publik dhe një aspekt i gjyqit publik është që të gjitha provat materiale të pranuar të jenë të qasshme nga publiku, të disponueshme për publikun. Prandaj lidhur me redaktimet që propozoni dua t'ju kujtoj se këto redaktime t'i mbani absolutisht në minimum", ka thënë gjyqtari.

E pas përmbledhjes së deklaratave të dëshmitares Pumper, avokatët mbrojtës të Gucatit dhe Haradinajt kanë bërë parashtrimet e tyre.

Avokati i Gucatit, Jonathan Elystan Rees, ka thënë se dëshmia e koordinatores së hetimeve në ZPS, Zdenka Pumper, nuk duhet të pranohet. "Tërësia e dëshmisë së znj. Pumper, qoftë me gojë, qoftë me dokumente, duhet përjashtuar, nuk duhet të pranohet sipas rregullës 138, nënregullës 1. Rregulla 13(1) parashikon se dëshmia nuk duhet të pranohet nëse vlera prodhuese është më e vogël sesa efekti dëmtues. Unë do të mbështetem në rregullën 138 në lidhje me dokumentet. Në fakt, baza për provueshmëri nuk është vërtetuar. Në lidhje me parashtrimin e parë znj. Pumper u thirr në emër të ZPS-së dhe dëshmoi për të

përmbledhur në fakt 4 siç i quan ajo paketat 1, 2, 3, 4, shumica e të cilave nuk janë provuar si dokumente prova materiale. Trupi gjykues nuk ka qasje në to për të bërë vlerësimet e tyre, as mbrojtja nuk është në gjendje t'i kontrollojë pohimet e saj lidhur me përmbajtjen e këtyre dokumenteve", ka thënë avokati Rees. Sipas tij, me veprimin e përmbledhjes së dokumenteve, dëshmitarja Pumper ka dhënë një opinion për përmbajtjen e tyre. Mbrojtja ka thënë se në këto rrethana dëshmitarja nuk mund të nxjerrë konkluzione për dokumentet. "Parashtrimet se kur përgatitet një përmbledhje e një dokumenti të tillë nga një palë, e cila do ta përdorë, ky nuk duhet quajtur i besueshëm kur materiali nuk është provë materiale përpara trupit gjykues, i cili mund të marrë mendim, që trupi gjykues të mbështetet me një përmbledhje të tillë dhe të nxjerrë vlerësimin e saj. Perceptimi i publikut do të ishte se një vendim i tillë është i pasigurt dhe këto janë fjalët e trupit gjykues të apelit në rastin e Milosheviqit. Referenca gjendet në poshtëshënimin 7, parashtrimi 007, dhe ne mendojmë që kjo është situata ku gjykata e gjen veten duke pasur dëshmi të tilla si

ajo e zonjës Pumper. Nuk është një vlerësim i pavarur", ka thënë avokati Rees.

Parashtrimin e avokatit Rees e ka mbështetur në tërësi edhe avokati i Nasim Haradinajt, Toby Cadman, Seanca gjyqësore ndaj Gucatit e Haradinajt do të vazhdojë me dëgjimin e dëshmitarit të radhës.

Pas koordinatores së hetimeve në ZPS-ja, dëshmitares së parë Zdenka Pumper, për dy ditë ka dëshmuar Halil Berisha, ish-gazetar dhe redaktor në gazetën "Infokus", ndërsa të enjten ka vazhduar dëgjimi i dëshmitarit të tretë.

Drejtimesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Gucati dhe Haradinajt, akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, frikësim të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Në organizatën që ata drejtonin kishin arritur disa pako që pretendohej të ishin me dokumente që kishin rrjedhur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Të gjitha këto ata i kishin bërë publike përmes konferencave për media dhe paraqitjeve të tjera publike.

KDI-ja kërkon nga komuna e Pejës zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike

PRISHTINË, 28 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), bazuar në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, me 30 shtator të këtij viti ka kërkuar nga komuna e Pejës (Drejtoria për Buxhet dhe Financa) qasje në kartelën analitike të kontos për shpenzimet financiare 1 janar 2021 deri më 30 shtator 2021 për të gjitha kategoritë buxhetore (paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe investime kapitale) edhe informata për shpenzimet e detajuara nga kartela analitike e kontos për nën kodet e shpenzimeve në

kategorinë e investimeve kapitale. “Që nga paraqitja e kërkesës për qasje në këto dokumente publike, komuna e Pejës, përveçse ka konfirmuar pranimin e kërkesës nga KDI-ja, nuk ka ofruar përgjigje zyrtare siç parashihet me ligj. Për më tepër, njëzet e nëntë (29) ditë pas kërkesës fillestare, më 20 tetor 2021, KDI-ja përmes postës elektronike ka rikujtuar komunën e Pejës në lidhje me kërkesën, por prapë nuk ka marrë ndonjë përgjigje”, thuhet në komunikatën e KDI-së. Neni 12 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, paragrafi 1, precizon qartë që “institucioni



publik detyrohet që brenda shtatë ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për

lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë

apo të pjesshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë”. “Andaj, bazuar në obligimet ligjore që kanë institucionet në raport me zbatimin e legjislacionit për qasje në dokumente publike, komuna e Pejës ka bërë shkelje të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe, për këtë, KDI rekomandon komunën e Pejës që ta zbatojë ligjin duke u garantuar qytetarëve qasje dhe informata të plota kurdo që shfrytëzojnë mekanizmat e tillë ligjorë”, është thënë në komunikatën e KDI-së.

Inspektoratet shëndetësore të Kosovës e të Shqipërisë shkëmbejnë përvojat e përbashkëta

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Një delegacion i Inspektoratit Shëndetësor i Shqipërisë, i kryesuar nga kryeinspektorja Vjollca Braho, është duke qëndruar për një vizitë punë në Republikën e Kosovës në kuadër të bashkëpunimit midis inspektorateve nga Kosova dhe Shqipëria. Delegacioni nga Shqipëria është pritur nga zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha dhe sekretari i përgjithshëm i MSh-së, Naim Bardiqi, shoqëruar nga ushtruesi i detyrës i zëvendëskryeinspektorit



shëndetësor në Kosovë, Shaban Osmanaj dhe këshilltari i ministres Gexha, Drin Podrimçaku.

Gjatë bashkëbisedimit në Ministri të Shëndetësisë, zëvendësministri Berisha dhe sekretari Bardiqi kanë

theksuar rëndësinë e bashkëpunimit midis dy inspektorateve në veçanti gjatë pandemisë Covid-19, për të kontribuar drejtpërdrejt në zbatimin e masave kundër Covidit në të dy vendet si rruga e duhur për t'u ballafaquar me sukses me sfidën që ka kërcënuar seriozisht shëndetin publik në nivel global dhe kombëtar. Zëvendësministri Berisha ka theksuar se ky është një segment i bashkëpunimit në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta midis dy qeverive respektive.

Kryeinspektorja Braho ka thënë se delegacioni nga Shqipëria është në

Kosovë për t'i shkëmbyer përvojat në fushën e inspektimit me qëllim që të dy inspektoratet ta ndihmojnë njëri-tjetrin.

Para takimit në MSh, delegacioni nga Inspektorati Shëndetësor i Shqipërisë ka zhvilluar një takim pune në Inspektoratin Shëndetësor ku janë trajtuar sfidat e dy inspektorateve dhe përvojat e inspektimit dhe monitorimit gjatë Covid-19.

Gjatë qëndrimit dyditor, të dy inspektoratet do të zhvillojnë inspektime të përbashkëta në disa komuna të Kosovës.

Mirëpritet projekti ‘Komunat për të rinjtë’



PRISHTINË, 28 TETOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka marrë pjesë në takimin virtual, me rastin e përmbylljes së misionit mbikëqyrës pesëditor të Bankës Botërore në kuadër të projektit “Komunat për të rinjtë” të financuar nga Fondi Japonez për Zhvillim Social (JSDF).

Gjatë fjalimit të tij, ministri Krasniqi ka falënderuar Paoluccin për bashkëpunimin korrekt dhe përkrahjen e plotë të Bankës Botërore për projektin “Komunat

për të rinjtë” i cili mbështet të rinjtë në nivelin lokal. “Jam shumë i kënaqur me bashkëpunimin dhe besimin të cilin e kemi ndërtuar përmes punës sonë të përbashkët. Projekti ‘Komunat për të rinjtë’ është shumë i rëndësishëm për ne, ngaqë u ofron mundësi të shkëlqyeshme të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në komunat përfituese”, ka thënë Krasniqi.

Menaxheri i Bankës Botërore për Kosovë, Massimiliano Paolucci,

ka shprehur mirënjohjen e tij të thellë për bashkëpunimin e plotë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe ka shtjelluar mundësitë për bashkëpunime të reja me MAPL-në në fushën e përkrahjes së grupeve të marginalizuara në Kosovë.

Projekti M4Y është një grant prej 2.79 milionë dollarësh i financuar nga Qeveria e Japonisë përmes mbështetjes së marrë nga Fondi Japonez për Zhvillimin Social i administruar nga Banka Botërore.

Anëtarë të Komisionit për Legjislacion diskutojnë me kreun e Supremes për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Enver Peci, së bashku me gjyqtarin Shukri Sylejmani, kanë pritur të enjten në takim deputetin e Kuvendit të Kosovës, Driton Selmanaj, në cilësinë e zëvendëskryetarit të parë të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, me qëllim

të diskutimit rreth zbatimit të ligjeve të caktuara që ndërliken me sistemin gjyqësor. Deputeti Selmanaj e ka njoftuar kryetarin Peci, se komisioni në fjalë ka formuar grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore. Kryetari Peci dhe gjyqtari

Sylejmani sqaruan para përfaqësuesve të Kuvendit mangësitë e hasura në ligjet përkatëse dhe sqarimet që Gjykata Supreme ka bërë duke nxjerr mendime juridike apo udhëzues, për paqartësitë dhe dilemat, posaçërisht të gjyqtarëve, si zbatues të këtyre ligjeve. Bashkëbiseduesit u pajtuan ta rritin bashkëpunimin në përpjekje për ta forcuar sundimin e ligjit.



Ekipe mobile për vaksinim në shtatë qytete të Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 TETOR - Në shtatë qytete të Kosovës ekipet mobile do të vazhdojnë edhe sot (e premte) të bëjnë vaksinimin e qytetarëve kundër Covid-19.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se ekipet mobile do të jenë të vendosura në sheshet kryesore të qyteteve Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjiilan.

Vaksinimi, ndërkohë, do të vazhdojë edhe në të gjitha qendrat e vaksinimit, thuhet në njoftim. Vaksinat që jepen në Kosovë janë "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca", të dyja të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Agjencia Evropiane e Barnave. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të enjten se në 24 orët e fundit janë dhënë 4 597 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të



gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 553 816 doza të vaksinës. Deri më sot 716 855 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Kjo ministri ka bërë me dije se nga 1 557 testime, 16 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të enjten janë shëruar edhe 16 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 292. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 428.

Kërcënohet kryeministri Kurti, rritet niveli i sigurisë për të



PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është kërcënuar, por nuk janë dhënë hollësi se nga kush ose në çfarë rrethana. Të mërkurën e 27 tetorit në mbrëmje afër shtëpisë së Kurtit është vërejtur prani më e shtuar e Policisë së

Kosovës.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, duke mos dhënë hollësi ka theksuar se si masë e kujdesit të shtuar është rritur edhe niveli i sigurisë për kryeministrin. Kurti ka thënë të enjten se nuk ndihet i rrezikuar,

por ka treguar se janë organet e sigurisë ato që i vlerësojnë kërcënimet dhe i ndërmarrin veprimet në përputhje me rrethanat e caktuara. "Janë mekanizmat e shtetit që i bëjnë vlerësimet kur ngjajnë kërcënime nëpër rrjete sociale, të cilat unë

nuk kam mundësi t'i ndjek", ka thënë Kurti në një konferencë për media në Prishtinë, pasi është pyetur nga gazetarët se a ndihet i kërcënuar dhe nga kush. "As dje e as sot nuk e kam ndryshuar agjendën time", shtoi ai. Zëdhënësi i Policisë së Kosovës,

Daut Hoxha, ka thënë se nuk ka mundësi të ofrojë informacione për këtë rast.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka kërkuar që të hetohet rasti i kërcënimit ndaj kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Inicohet debat parlamentar për ngritjen e çmimeve

PRISHTINË, 28 TETOR - Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka iniciuar debatin parlamentar në Kuvendin e Kosovës për ngritjen e çmimeve të produkteve elementare. Shefi i grupit parlamentarë i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për media të

enjten, ka thënë se ngritja e çmimeve është një problem shqetësues dhe duhet të adresohet edhe në legjislativ. Në këtë drejtim Tahiri e ka kritikuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për deklarimet e tij për rolin e qeverisë në ngritjen e çmimeve. "A është Albin Kurti i tanishmi që thotë se

qeveria nuk i rritë çmimet, apo i atëhershmi i cili thoshte se do të ndërmerrej për ulje të çmimeve? A ka mashtruar atëherë, apo është e vërtetë ajo çfarë po thotë tash?", ka pyetur Tahiri. Ndërsa vendimet e fundit të qeverisë për ndihma ndaj qytetarëve, Tahiri i ka quajtur elektorale.



Qeveria subvencionon kreditë e bizneseve prodhuese

EPOKA E RE **Albulena S. MAVARAJ**

PRISHTINË, 28 TETOR - Daljen nga pandemia qeveria e sheh si një mundësi të re për ta riorientuar ekonominë drejt prodhimit dhe eksportit, drejt rritjes së punësimit të dinjitetshëm, si dhe drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike. Andaj me qëllim të forcimit të pozitës së prodhuesit vendor në treg, në linjë me programin qeverisës, kryeministri Kurti Albin dhe ministri Hekuran Murati kanë paraqitur të enjten operacionalizimin e masës 2.1 - Mbështetja për kredi investive dhe masës 2.4 - Rritja e eksportit. Operacionalizimi e zbatimi i këtyre dy masave synon që ekonomia vendore të fokusohet në prodhim e eksport ashtu që të kemi rritje ekonomike të qëndrueshme, e cila u bënë ballë lëkundjeve të tregut të jashtëm. Kryeministri Kurti ka thënë se

periudha pandemike, përveç vështirësive që ka sjellë, gjithashtu ka qenë një kohë reflektimi e mësimi, që na ka bërë që edhe më shumë ta kuptojmë potencialin dhe rëndësinë e prodhuesit vendor.

Në anën tjetër, ministri Murati ka shpalosur hollësitë lidhur me kushtet dhe kriteret për përfitim nga masat 2.1 dhe 2.4, të cilat synojnë nxitjen e investimeve në kapacitete të reja prodhuese dhe eksportuese, rritjen e konkurrueshmërisë dhe cilësisë së prodhimit vendor, ngritjen dhe standardizimin e cilësisë, si dhe aftësimin e punëtorëve dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Sipas masës 2.1 - Subvencionimi i kredive investive parashihet subvencionimi i kredive investive për bizneset prodhuese dhe përpunuese në vlerë prej 20-përqindësh të kredisë; subvencionimi i kredive investive për bizneset në pronësi të grave në vlerë prej 20-përqindësh të



kredisë, si dhe subvencionimi i kredive për bizneset që kanë nevojë për likuiditet në vlerë prej 10-përqindësh të kredisë.

Në anën tjetër, masa 2.4 - Mbështetja e eksportit parashihet mbështetjen financiare për bizneset prodhuese dhe

përpunuese në subvencionimin deri në 10 000 euro për ngritjen e kapaciteteve të stafit menaxherial për certifikim profesional; subvencionimin deri në 20 000 euro për ngritjen e kapaciteteve të stafit të angazhuar në prodhim;

subvencionimin deri në 50 000 euro për aktivitetet lidhur me brendimin dhe marketingun e produkteve; si dhe subvencionim deri në 50 000 euro për pjesëmarrjen në panairë jashtë vendit si mundësi e gjetjes së tregjeve të reja.

'KEDS Academy 9' fillon së shpejti, 70 të rinj do të bëhen pjesë e këtij programi



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 28 TETOR - KEDS Academy po hap dyert për gjeneratën e nëntë me radhë, duke ftuar nxënësit dhe studentët e universiteteve publike dhe shkollave të mesme teknike të Kosovës që të aplikojnë në këtë program.

Afati për aplikim ka filluar më 27 tetor dhe do të zgjasë deri më 12 nëntor.

Programi është i themeluar dhe mbështetur nga KEDS-i, përderisa ligjërues janë profesorët e universitetit prestigjioz Bogaziçi nga Turqia, si dhe ekspertët e KEDS-it të cilët janë të kyçur në veprimtaritë përkatëse që ligjërohen në program. "Për më tepër, tash e 9 vjet KEDS-i ka marrëveshje bashkëpunimi për programin e KEDS Academy me Universitetin e Prishtinës 'Hasan Prishtina' dhe Ministrinë e Arsimit

Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë. Pjesë e programit KEDS Academy mund të bëhet secili student i vitit të fundit të studimeve në drejtimet e përzgjedhura dhe nxënësit e shkollave të mesme teknike profesionale. Pra, është programi i liderit për studentët e Universitetit të Prishtinës dhe programi teknik industrial për nxënësit e shkollave të mesme teknike në Prishtinë. Gjatë një viti sa zgjat programi KEDS Academy, studentët do të ndjekin ligjëratat, si dhe do të bëjnë punë praktike nëpër departamente të ndryshme të kompanisë", ka njoftuar KEDS-i.

Në fund të programit, pjesëmarrësit do të vlerësohen në bazë të performancës së tyre dhe varësisht prej angazhimit, pas përfundimit të programit, pjesëmarrësit e suksesshëm do të kenë mundësi punësimi në KEDS. Ky program ka fituar disa çmime

ndërkombëtare në qendra të rëndësishme botërore, si në Uashington, Paris dhe Londër, ndërsa sot vazhdon të jetë një derë e hapur e mundësive për të rinjtë dhe të rejtat e Kosovës.

Deri më tani në KEDS Academy

kanë diplomuar më shumë se 400 studentë dhe nxënës dhe një numër i konsiderueshëm i tyre punojnë në KEDS, përderisa të tjerët e kanë gjetur veten në kompani të tjera brenda dhe jashtë Kosovës.


KEDS-i mbetet kompani e përkushtuar për avancimin profesional të të rinjve kosovarë përmes projekteve të shumta zhvillimore në sektorin e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës (CSR).



Protestojnë punëtorët e kompanisë "Feronikel"-i

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Kriza energjetike në Evropë dhe ngritja e çmimit të energjisë elektrike në tregjet globale ka bërë që kompania "Feronikeli" ta ndërpresë përkohësisht punën. Në shenjë pakënaqësie, punëtorët e kësaj fabrike të enjten kanë protestuar në Prishtinë

para objektit të Qeverisë së Kosovës. Kompania "Feronikeli" ka mbi 800 të punësuar dhe 200 bashkëpunëtorë përmes kontraktorëve të saj të cilëve iu siguron të ardhura të rregullta, gjë që e rrit në mbi 1 000 persona numrin e bashkëpunëtorëve të kompanisë.



Letërkëmbimi i Mid'hat Frashërit

“Një letër (përmbajtjen e së cilës, duhet jo vetëm ta ndjejmë, akoma

ta shijojmë) për mua është një luks, një dëfrim i mendjes dhe luksi

do nge, do qetësi, do një atmosferë të paturbulluar. Luksi i nxituar,

degjeron në grotesk. Shkoni dhe shihni qytetin amerikan Alantic

City, ku harbutësia e një luksi të shpejtë e bën një kontrast aq të madh me bukuritë evropiane të shekullit XVII-XVIII”

Mid'hat Frashëri

Letërkëmbimi i Mid'hat Frashërit përbën kurorën e meditim, të veprimtarisë shkrimore dhe krijimtarisë së tij: aty shfaqen idetë e reja iluministe të tij në çdo fushë të jetës e të mendimit, sfidat dhe vendimmarrja e tij në ngjarjet kyçe të historisë së kombit, shqiptarizmi si platformë dhe veprim, përpjekjet titanike në mbrojtje të çështjes shqiptare në krizë, këmbëgjulja e palodhur për zgjidhjen më pozitive të saj, humanizmi dhe evropianizmi si frymë e model, diplomacia si mjeshtëri dhe art, debati me argumente dhe logjikë të pakundërshtueshme, elokuenca dhe sjellja fisnike, bashkëbisedimi dhe polemikat me personalitete të shquara historike shqiptare e të huaja, përfshirë presidentë

shtetesh, kryeministra, ministra, kryetarë forumesh kombëtarë e ndërkombëtarë, bashkëpunimi e bashkimi kombëtar, haxhiqamilizmi shqiptar, rreziku komunist, lufta për shtet ligjor dhe demokraci, miqësia dhe dashuria, por edhe kritika ekzistenciale, largpamësia, kultura sipërore, informacioni i gjerë dhe sensi zyrtar, por edhe intim dhe artistik i këtij letërkëmbimi.

Tre janë kulmet e kësaj pasurie epistolare: koha kur ishte anëtar dhe kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe në Lidhjen e kombeve në Gjenevë në mbrojtje të identitetit dhe tërësisë teritoriale të Shqipërisë përkunder politikave pushtuese serbe, greke dhe italiane, por edhe kundër politikave imperialiste të Fuqive të Mëdha shpesh në mbështetje të tyre, si edhe në mbrojtje të popullsisë shqiptare të Kosovës dhe të Shqipërisë jug-lindore të okupuara padrejtësisht dhe të persektuara deri në asgjësim; letërkëmbimi kur ishte ambasador i Shqipërisë në Greqi, ku mbrojti si askush tjetër çështjen çame, duke u përballur me politikant antishqiptarë dhe antinjerëzore të helenizmit për shpërnguljen barbare dhe shpronësimin e popullsisë shqiptare nga trojet e tyre në vitet 1923-1925; dhe letërkëmbimi erotik, që zgjati thuajse gjithë jetën, ashtu siç zgjati edhe dashuria e tij.

Dashuria e Mid'hat Frashërit ishte shpuzë e amëshuar, e mbuluar me hirin e jetës. Ai i caklon dhe i shpupurit me penën-pupël gacat, që vagëllojnë në një dritë të gjelbër dhe i derdh me mjeshtëri dhe art në letrat e tij. Dashuria e tij është e çiltër, e vetvetishme, e magjishme, emocionale. Ai e ka provuar atë me pasion më tepër se një herë, si njeri

i lirë dhe i kulturuar, atë ndjesi të brendshme të patjetërsueshme njerëzore, atë prush që djeg e shqerr, si një dritë dhe terr, si shend e vuajtje, si poezi e si dramë, si forcë njerëzore që e çliron dhe e ndryshon botën.

“Dashuria, shkruan ai, është kondita e jetës. Po të mos ekzistojë ajo, shkatërrohet lidhka në mes të gjymtyrëve të njeriut, familjes dhe njerëzisë, zhduket shija e gjallërisë dhe e jetës. Pa dashuri s'ka entuziazëm, s'ka shpresë, nuk kryhet asnjë vepër. Enthusiazmi dhe shpresa, bijat e dashurisë së sinqertë dhe të thellë, duhet të jenë si ata trëndafilë mëngjesi, që çelin çdo ditë të rinj, si ato lulet, që mbyllen natën, por hapen nën rrezet e para të diellit”

Letrat e dashurisë mes intelektuale rumune Angela Romano dhe Mid'hatit zgjasin e dokumentohen për 24 vjet me radhë, pak më tepër se letrat e dashurisë mes Balzakut dhe Princësës Hanska, por edhe me një pathos të papërkrahur.

Pyetjes: Pse nuk u martua kurrë Mid'hat Frashëri, i japin përgjigje letrat e tij dhe të dashurave të tij. E zhuritur nga malli dhe largësia, Angela Romano e grish në Bukuresht të dashurisë së saj, ku i kishte të gjitha komoditetet që të jetonin së bashku “me idhullin e saj, shpesën e saj të përcaktueshme”, siç shprehet ajo në letër. Por Mid'hat zgjedh midis Angelës dhe Shqipërisë, këtë të dytën dhe ajo ia kthen: “Jam e lumtur për ty dhe për vendin tënd”.

Mid'hat i përgjigjet së dashurës Emma: “Ti e di sëmundjen morale nga e cila unë vuaj, ajo mani për t'i analizuar gjërat, ajo ngasje për të gërmuar përherë në thellësi të tyre, duke dashur të shoh larg, ta konsideroj shumë shpesh të tashmen si preokupim të së

ardhmes. Një martesë, për mua është e pamundur dhe jam i sigurt se nuk do ta bëja kursesi të lumtur”. Në letrën drejtuar Elsës, Mid'hati shkruante: “Të dua të lumtur, Elsa. Po luftoj midis zemrës dhe arsyes, midis dashurisë dhe detyrës, pikërisht në emër të kësaj dashurie”. Elsa: “Mbase është një marrëzi e madhe dashuria ime për ty, që e do aq shumë lirinë, të udhëtosh, t'i biesh botës qark, tek do ndryshimin, jetën pa halle, pa telashe”.

Mid'hati ishte një qytetar i lirë evropian, ndaj përpjetej jo pa dilemma, që pasioni dhe jeta familjare të mos ia pengonin dashurinë e madhe ndaj atdheut dhe detyrën ndaj çështjes kombëtare, si edhe të mos lëndonin njerëzit e dashur.

Mid'hati pati një letërkëmbim të pazakontë, nga përmbajtja e thuktë, por edhe nga shumësia e letrave, që arrijnë në mijëra e mijëra. Të habit fakti që ku e ka gjetur kohën të shkruajë letra pa fund, kur ka pasur një veprimtari tejet intensive atdhetare, politike, diplomatike, pedagogjike, kulturore, studimore, albanologjike, kritike, botuese, letrare, memoriale, bibliografike dhe përshkrime udhëtimesh brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Ai ka shkruar dhe këmbyer letra nga nevoja e kohës, me personalitete, por edhe njerëz të thjeshtë të botës shqiptare si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Faik Konica, Mehmet Konica, Kristo Luarasi, Gaetano Petrota, Dr. I.Temo, Dr. M. Turtulli, Fan Noli, Sulejman Delvina, Shtjefën Gjeçovi, Gjergj Fishta, Gjergj Pekmezi, Ahmet Zogu, Sotir Kolea, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Dhimitër Berati, Aqif Pashë Elbasani, Eshref Frashëri, Pandeli Evangjeli, Arif Dino, Asdreni, Kolë

Tromara, Kostë Çekrezi, Mihal Grameno, Avni Rustemi, Samin Visoka, Branko Merxhani, Mirash Ivanaj, Seit Kemal, Hil Mosi, Kolë Kamsi, Karl Gurakuqi, Musine Kokalari, Emine Frashëri, Abaz Kupi, Dhimitër Falo, Safet Butka, Sali Mani etj; por edhe me personalitete të shquara të politikës e diplomacisë botërore si presidenti Wilson, Lord Robert Cecil, kryetar i Konferencës së Paqes në Paris, Jules Cambon, kryetar i Konferencës së Ambasadorëve, Eric Drumond, sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, D'Estornuelles de Constand, Lloyd George, Aristide Briand, Aubrey Herbert, Edit Durham, Justin Godart, Baron Hayashi, Telford Erickson, Jean Pelissier, I.S. Barnes, Morton Eden, A.J.Balfour, Rene Vivian, K.Ishii, Bill Maklin, Alexandër Kirk, Julian Emer etj. si edhe ministra, deputetë, këshilltarë, ambasadorë, shkrimtarë, kryeredaktorë agjencish, gazetash e revistash, miq dhe armiq të Shqipërisë dhe të Mid'hat Frashërit.

Po ashtu, pati letërkëmbim me personalitete të shkencës evropiane si M.Shuflai, G.Weigand, E.Pittard, M.Roques, M. Tomasië, H. Pedersen, N. Jokli, Prof.Meillet, E.Legrand etj. Letërkëmbimi është hulumtuar dhe nxjerrë në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Jashtme dhe arkivat e bibliotekat e Turqisë, Francës, Britanisë së Madhe, SHBA, Greqisë, Rumanisë, Bullgarisë, Zvicrës, Gjermanisë, Italisë, etj, kryesisht në gjuhët shqip, frëngjisht, anglisht.

Ky letërkëmbim është ngërthyer tek vëllimi VI dhe VII i kolanës “Mid'hat Frashëri- Vepra të zgjedhura” botim i Institutit të Studimeve Historike “Lumo Skëndo” Tiranë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Selmani: Në Drenas kërkojmë tri pikët e plota

Futbollisti Kastriot Selmani ka paralajmëruar fitore në ndeshjen kundër Feronikelit e cila zhvillohet në fundjavë në kuadër të javës së dymbëdhjetë. “Synimet ndaj Feronikelit padyshim që do të jenë vetëm tri pikët e plota, sepse ne nuk duhet të lëshojmë pikë në ndeshjet e ardhshme”, ka thënë Selmani



EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 TETOR - Skuadra e Llapit në xhiron e kaluar në BKT Superligën e Kosovës në futboll pësoi humbje nga Drita (1-3), por në mesjavë e fitoi Superkupën “Kosovë - Diasporë”, pasi e mposhti FC Kosova Dusseldorf me rezultat 2-0. Ndeshjen e radhës skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina e zhvillon të shtunën në Drenas kundër Feronikelit, derisa të enjten për “Epokën e re”, Kastriot Selmani, ka folur rreth kësaj ndeshje. Ai ka thënë se Llapi nuk ka hapësirë më për gabime dhe në

këtë ndeshje është opsion vetëm fitorja. “Synimet ndaj Feronikelit padyshim që do të jenë vetëm tri pikët e plota, sepse ne nuk duhet të lëshojmë pikë në ndeshjet e ardhshme”, ka thënë Selmani. Llapi nuk e nisi në mënyrën më të mirë edicionin 2021/22, por Selmanaj është optimist se kjo skuadër në fund të kampionatit mund të fitojë trofe. “Them të drejtën, nuk jemi të kënaqur me rezultatet në këto xhiro sepse kemi pretenduar pjesën e lartë të tabelës dhe kemi lëshuar shumë pikë. Do të luftojmë deri në fund që ta fitojmë titullin e kampionit. Kampionati ende është i gjatë”, ka

deklaruar ai. Futbollisti që po kalon nëpër një formë të jashtëzakonshme ka kontratë me skuadrën llapjane deri në qershor të vitit të ardhshëm. Ai ka bërë me dije se është ende pa ndonjë plan rreth të ardhmes, pasi është i fokusuar vetëm në rezultatet e klubit. “Kontrata me Llapin më skadon në qershor dhe për momentin jam i fokusuar vetëm te skuadra e Llapit në kampionat, pastaj do të shikojmë”, ka shtuar Selmani. Skuadra e Llapit aktualisht pozicionohet në vendin e shtatë me 12 pikë, duke regjistruar tri fitore, tri barazime dhe pesë humbje.

SHKURT

Besa mposhti Kastriotin

Besa Famgas u është kthyer sfidave vendore pas suksesit në Ligën Evropiane. Besa e luajti ndeshjen e mbetur të xhiros së gjashtë të Superligës ndaj Kastriotit. Ndeshja në Ferizaj përfundoi me fitoren 36:30 të Besës, por ekipi pejan te fitorja ka arritur vetëm në pjesën e dytë. Pas pjesës së parë rezultati ishte i barabartë 17:17. Në pjesën e parë kryesisht në epërsi ishte Kastrioti. Epërsia e vendasve shkoi deri në tri gola, 10:7. Në pjesën e dytë Besa Famgas nisi shkëputjen e lehtë, por vendasit mbaheshin në lojë. Vetëm pas minutës së 50 epërsia e Besës ishte më e lartë. Në fund rezultati ishte 36:30 për Besën. Nikola Prce e Arbios Mushkolaj ishin më efikasit te Besa me nga 5 gola. Nga 4 gola i kanë shënuar Jon Vokshi, Egzon Gjuka, Denis Shabanoviq, Yll Muqolli e Deniz Terziqi. Te Kastrioti u dalluan Festim Mustafa me 9 gola dhe Jeton Bislimi e Hamdi Salih me nga 8. Me fitore Besa Famgas është kthyer në pozitën e parë. I ka dhjetë pikë nga pesë ndeshje, sa i kanë edhe Trepça e Prishtina, por nga gjashtë ndeshje. Kastrioti është i shtati me 4 pikë.

Fitorja e gjashtë radhazi për KHF Istogu

KHF Istogu ka vazhduar me fitore në Superligën e hendbollistëve. Istogu e luajti ndeshjen e mbetur të javës së pestë ndaj “Jusuf Gërvallës”. Takimin e zhvilluar në Deçan e fituan istogaset me rezultat 38:18. Pas 30 minutave lojë rezultati ishte 17:8 dhe u bë e qartë se dallimi në cilësi ekzistonte. Kapitenia Albina Rugova i shënoi 9 gola, ndërsa nga 8 Adelina Berisha e Anja Bojaniq. Te “Jusuf Gërvalla” u shqua Eriona Gecaj me 11 gola. Për Istogun ishte fitorja e gjashtë rresht. Udhëheq në tabelë me 12 pikë. “Jusuf Gërvalla” mban vendin e dhjetë me 4 pikë.

Shkarkohet Koemani, Sergi Barjuan emërohet trajner i përkohshëm

Skuadra e Barcelonës e ka shkarkuar trajnerin Ronald Koeman pas humbjes që pësoi Rayo Vallecano të mërkurën në mbremje. Barcelona të enjten e ka emëruar trajner të përkohshëm Sergi Barjuan që ishte në ekipin B. “Barcelona bën me dije se Sergi Barjuan, trajneri aktual i Barçës B, do ta marrë provizorisht drejtimin teknik të ekipit të parë. Pozicioni i përkohshëm në stolin e ekipit të parë do të mbyllet sapo klubi ta mbyllë punësimin e një trajneri të ri, pas shkarkimit të Ronald Koemanit”, thuhet në njoftimin e Barcelonës. Xavi pritet të jetë trajneri i ri i Barcelonës.

Kosova grumbullohet sot në Mitrovicë

PRISHTINË, 28 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll grumbullohet sot (e premte) për dy ndeshjet e para kualifikuese për Botërorin 2023. Grumbullimi bëhet në “Hotel Internacional Prishtina”. Stërvitjen e parë “dardanët” e zhvillojnë në kompleksin “Omni Sport” në

Mitrovicë. Stërvitja e parë mbahet prej orës 18:00 e deri në orën 20:00. Në Mitrovicë, Kosova i zhvillon stërvitjet edhe të shtunën dhe të dielën. Të hënën Kosova zhvendoset në Pallatin e Rinisë në kryeqytet ku i kryen dy seancat e fundit stërvitore para udhëtimit për në Turqi.

Udhëtimi për në Turqi bëhet të martën në mëngjes. Ndeshja Turqi - Kosovë zhvillohet të mërkurën e ardhshme, më 3 nëntor, në Eskishehir. Më 7 nëntor në Prishtinë është ndeshja Kosova - Belgjika. Synim i Kosovës është dy pozitë e para në grup për të avancuar tutje.



Red Bull: Fitojmë dy garat e radhës dhe Verstappen shpallet kampion

MILTON, 28 TETOR - Një nga drejtuesit e Red Bullit, Helmut Marko, shprehet se skuadra austriake është shumë pranë fitimit të titullit kampion bote në Formula 1 me Max Verstappen. Piloti i ri holandez ka 12 pikë avantazh ndaj Lewis Hamiltonit,

ndërkohë që kanë mbetur edhe 5 gara nga përfundimi. "Tri garat e fundit u zhvilluan në pista që ishin në favor të Mercedesit. Dy garat e radhës, në Meksikë e Brazil, janë në pista që favorizojnë Red Bullin. Kam thënë që në fillim të sezonit se

për të fituar titullin na duhen 10 fitore, për të kontrolluar më pas avantazhin në tri garat e fundit në Lindjen e Mesme", ka thënë Marko. "Në 3 garat e fundit kemi pista me pjesë të drejta të gjata që favorizojnë Mercedesin, ndaj dy garat e radhës janë thelbësore

për ne. Nëse i fitojmë ato, shpallemi kampionë bote me Verstappenin. Ne jemi gati për çdo pistë, duke synuar fitoren edhe kur nuk jemi favoritë, siç ndodhi në Amerikë, ku përmbysem strategjitë e fituam", ka shtuar Marko.



Marmarinos zbardhi listën e gjerë të Kosovës

PRISHTINË, 28 TETOR - Përzgjedhësi i Kosovës A, Christos Marmarinos, në konsultim me shtabin teknik, ka shpallur listën e gjerë të basketbollistëve për ndeshjet e nëntorit. Në listën e gjerë janë 17 basketbollistë të cilët do të mbikëqyren nga shtabi teknik dhe drejtori i përfaqësuesve, Granit Rugova dhe më pas do të shpallet lista përfundimtare. Përzgjedhësi Marmarinos në fillim të muajit nëntor do të vijë në Kosovë, ku së bashku me Rugovën do të takojnë lojtarët dhe do t'i shohin nga afër ndeshjet, ku aktivizohen basketbollistët e Kosovës. Për shkak të rregullave nga FIBA nuk do të ketë grumbullim dhe 12-shja përfundimtare do të shpallet më 20 nëntor, kurse më 22 nëntor do të udhëtojnë drejt Norvegjisë, ndërsa ndeshja kundër norvegjezëve do të zhvillohet më 25 nëntor. Basketbollistët më 26 dhe 27 nëntor do të stërviten në Prishtinë, kurse më 28 nëntor do të përballen me Danimarkën. Sa



iu përket të ftuarve, për herë të parë te Kosova A është ftuar basketbollisti i talentuar që luan në Belgjikë, Fatlind Shoshaj dhe kapiteni i Sigal Prishtinës, Muhamedali Janjeva. Numri i kombëtareve pjesëmarrëse në parakualifikime të Euro 2025 është 10, ku një grup përbëhet nga katër kombëtare, kurse dy grupe të tjera me nga tri kombëtare. Katër skuadra, tre fituesit e grupeve, dhe një kombëtare e cila është e renditur në pozitën e dytë, më se miri do të

kualifikohen për raundin e dytë para-kualifikues. Raundi i dytë do të mbahet midis gushtit 2022, nëntor 2022, shkurt 2023.

Lista e gjerë

Divine Myles, Valon Bunjaku, Fatlind Shoshaj, Arti Hajdari, Dardan Berisha, Mikaile Tmusiq, Denis Zenelaj, Erjon Kastrati, Altin Morina, Meriton Ismaili, Drilon Hajrizi, Samir Zekiqi, Muhamedali Janjeva, Gëzim Morina, Fisnik Rugova, Urim Zenelaj, Dion Sheqiri.

Lakersat befasohen nga Oklahoma, Miami triumfon kundër Brooklynit

OKLAHOMA, 28 TETOR - Ndeshjet e luajtura në NBA kanë sjellë pafund surpriza, teksa janë mundur të gjitha ekipet pretendente. Duke nisur nga lakersat, që humbën 123-115 në fushën e Oklahomës. Humbje e papritur, pasi kalifornianët udhëhiqnin me 26 pikë avantazh (Davis 30 pikë e Westbrook 20 pikë, 14 rebounde e 13 asistime). Atëherë kur



lakersat menduan se e fituan ndeshjen, erdhi përmbysjë e Oklahomës, që korri suksesin e parë në kampionat (Shai 27 pikë). Një fakt interesant, që lakersat asnjëherë në histori nuk kishin humbur një takim kur kishin një avantazh të tillë. Lakersat i kishin fituar të 230 ndeshjet kur udhëhiqnin me 25

pikë. Humbet edhe skuadra e Brooklynit, që u mund 106-93 nga Miami, në një takim ku u dallua Adebayo, me 24 pikë. Ndërsa 25 pikët e Durantit mbetën për statistikë. Zhgënjën kampioni Milwaukee, që u ndal 113-108 nga Minnesota (Russell 29 pikë, Towns e Eduards nga 25 pikë secili).

REZULTATET

Orlando - Charlotte	111-120
Boston - Washington	107-116
Brooklyn - Miami	93-106
New Orleans - Atlanta	99-102
Toronto - Indiana	118-110
Milwaukee - Minnesota	108-113
Oklahoma - Lakers	123-115
Phoenix - Sacramento	107-110
Portland - Memphis	116-96
Clippers - Cleveland	79-92

Bayerni në janar synon transferimin e Osimhenit

Bayern Muncheni e ka etiketuar sulmuesin e Napolit, Victor Osimhen, si objektivin e madh për sulmin. 22-vjeçari

ka bërë një fillim të shkëlqyeshëm të sezonit me gjigantët italianë, duke shënuar nëntë gola në 11

ndeshje. Paraqitjet e tij të mira dhe statistikave mbresëlënëse para portës kanë bërë që shumë klube evropiane ta

duan transferimin e Osimhenit. Bayerni dëshiron ta transferojë Osimhen në afatin kalimtar të janarit për të

shmangur çdo konkurrencë. Megjithatë, Napoli thuhet se nuk do të pranojë asnjë ofertë më të ulët se 100 milionë euro.

SHKURT

Chelsea konsideron rikthimin e Brojës në janar

Chelsea është duke konsideruar ta ndërpresë huazimin e sulmuesit Armandao Broja te Southamptoni gjatë afatit të janarit. 20-vjeçari ka shkëlqyer te Southamptoni në javët e fundit, duke qenë titullar dhe shënuar ndaj Wolvesit dhe Burnleyt. "Goal" raporton se Chelsea ka vendosur klauzolë në marrëveshjen e Brojës, që ka të drejtë ta aktivizojë për ta rikthyer në afatin kalimtar dimëror. Skuadra e Thomas Tuchelit është pa dy sulmuesit Romelu Lukaku dhe Timo Werner, që u lënduan në fitoren 4-0 ndaj Malmos. Tekniku gjerman tani është duke menduar idenë që ta rikthejë Brojën në ekipin e parë, që të garojë me Lukakun dhe Wernerin, kur këta dy të jenë në formë. Ndërsa trajneri i Southamptonit dëshiron ta mbajë shqiptarin ngaqë beson që do të shkëlqejë në vitet në vijim. Broja shënoi tre gola në aq ndeshje gjatë parasezonit, duke shënuar 11 herë në 34 paraqitje në të gjitha garat për Vitessem gjatë sezonit 2020/21.

'Marca' zbulon fituesin e 'Topit të Artë'

"Topin e Artë" këtë sezon e fiton Robert Lewandowski, nuk ka asnjë dyshim për këtë në Spanjë. "Marca" ka bërë publike klasifikimin e lojtarëve, në një kohë kur votimi është mbyllur javën e shkurtar, ku gazetarë, kapitenë dhe trajnerë kanë shprehur pëlqimet e tyre. Trofeu më i rëndësishëm individual do të bëhet publik më 29 nëntor, por në Spanjë dhe jo vetëm kanë zbuluar përpara kohe fituesin. Fillimisht në rrjet qarkulloi një foto e rezultateve të votimeve, ndërsa më pas edhe "Marca" e konfirmoi. Lewandowski mposhti në këtë garë Lionel Messin i cili është lojtari i dytë më i votuar. Në vendin e tretë renditet sulmuesi i Real Madridit, Karim Benzema. Zhgënjën Cristiano Ronaldo, i cili renditet vetëm në vendin e nëntë, duke lënë pas emra si Erling Haaland, Ngolo Kante, Kylian Mbappe, Jorginho dhe Momo Salah. Ky çmim është një shpëtim për sulmuesin e Bayern Munchenit pasi "France Football" vendosi të mos e akordonte një vit më parë ku Leva arriti të fitojë gjithçka me Bayern Munchenin. Pavarësisht këtij fakti, polaku nuk e uli ritmin e tij duke qenë golashënuesi më i mirë në Evropë dhe duke thyer rekorde të pabesueshme.

Biznesmeni 67-vjeçari shpallet fajtor për vdekjen e Salas

Biznesmeni i cili e organizoi fluturimin, në të cilin vdiq futbollisti Emiliano Sala, është shpallur fajtor për rrezikimin e sigurisë së aeroplanit nga një gjykatë në Uells. Sala dhe piloti David Ibbotson humbën jetën kur aeroplani me të cilin po udhëtonin u rrëzua në Kanalin Anglez në janar të vitit 2019. David Henderson, një biznesmen 67-vjeçar në Yorkshire në Angli, u shpall fajtor të enjten nga Gjykata e Kardifit në Uells. Ai e kishte pranuar se kishte tentuar ta aranzhonte një fluturim për një pasagjer pa leje apo autorizim. Jurisë iu deshën shtatë orë e gjysmë për ta shpallur fajtor Hendersonin. Dënimi ndaj tij do të shqiptohet më 12 nëntor. Ibbotson, i cili punonte për Hendersonin rregullisht, nuk kishte leje të pilotit komercial, nuk ishte i kualifikuar për të fluturuar natën dhe vlerësimi i tij për ta drejtuar aeroplanin me një motor kishte skaduar. Sulmuesi argentin Sala dhe Ibbotson vdiqën pasi aeroplani i tyre me një motor ra në Kanalin Anglez gjatë fluturimit nga Nantes drejt Kardifit në janar 2019. Fluturimi ishte organizuar nga Henderson. Sala po shkonte në Kardif për ta kompletuar kalimin nga Nantes në Cardiff City për një marrëveshje prej 15 milionë funteve.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a



Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë:27/10/2021 me nr ref: 01/0847, Policia e Kosovës shpall:

KONKURS

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit.

Vendi i punës: Policia e Kosovës

A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kritere:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar);
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

B. Testet:

- Testi me shkrim;
- Testi i aftësive fizike;
- Intervista;
- Testi psikologjik;
- Kontrollimi mjekësor;
- Verifikimi i të kaluarës.

C. Forma e aplikimit:

Aplikimi në konkursin për zyrtarë policorë është online përmes ueb faqes zyrtare të PK-së: www.kosovopolice.com / Shpallje/Mundësi punësimi.

D. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera;
- Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime;
- Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës;
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokumenti nga pika c dhe d të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

E. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë

- Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat;
- Të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajnë rendin dhe sigurinë publike;
- Të parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të hetojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion;
- Të menaxhojnë dhe të kontrollojnë kufirin shtetëror;
- Të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- Të kryejnë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

F. Zbatimi i vendimit të datës 27/10/2021 me nr ref: 01/0847 për zbatimin e masave të veçanta të përkohshme afirmative

Në këtë konkurs Policia e Kosovës do të ndërmer masa të veçanta të përkohshme afirmative me qëllim të garantimit të të drejtave të barabarta gjinore, promovimit të barazisë gjinore dhe me qëllim të rritjes së përfaqësimit të zyrtarëve policorë gra në Policinë e Kosovës.

Masat e veçanta të përkohshme afirmative që do të ndërmer Policia e Kosovës do të zbatohen në procedurën e rekrutimit dhe punësimit në Policinë e Kosovës, në mënyrë që gjatë procesit të rekrutimit të zyrtarëve policorë nga të gjithë ata kandidatët që do të plotësojnë kushtet dhe kalojnë pragun e kalueshmërisë 70% përparësi do të këtë gjinia femërore.

Aplikimi për zyrtar policor bëhet online. Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë përmes ueb faqes zyrtare të Policisë së Kosovës: www.kosovopolice.com nga data **28.10.2021** deri me datën **16.11.2021**.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1554 apo 1722 si dhe në 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes së aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimeve do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolice.com dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

“Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/Uprava za Ljudske Izvore PK-a

Na osnovu Zakona o Policiji, Poglavlje V, člana 44, Zakona o Radnom Odnosu Br. 03/L-212, Poglavlje II, član 8, Zakon o Ravnopravnosti Pola br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakon o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 8 i 9, tačka 1 i 2 i Odluke Generalnog Direktora:27/10/2021 pod br. ref: 01/0847, Policia Kosova objavljuje:

KONKURS

Za prijem policijskih službenika prema predviđenim uslovima konkurisanja.

Radno mesto: Policia Kosova

A. Kandidati koji apliciraju za policijskog službenika u Policiji Kosova treba da ispunjavaju sledeće uslove:

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da je uzrasta od 18-30 godine;
- Da ima završenu srednju školu;
- Da je u dobrom fizičkom, mentalnom i emocionalnom stanju;
- Da nije kažnjavan za neko krivično delo;
- Da nema na vidno mesto tetovaže (lice, vrat, ruke)
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti;

B. Testovi:

- Pismeno testiranje;
- Testiranje fizičkih sposobnosti;
- Intervjuisanje;
- Psihološko testiranje;
- Lekarska kontrola;
- Provera prošlosti;

C. Način apliciranja:

Apliciranje na konkurs za policijske službenike je online putem službene veb stranice PK-a: www.kosovopolice.com / Oglas/Mogućnosti za zapošljavanje.

D. Aplikaciji priložiti potrebnu dokumentaciju:

- Kopja diplome za srednje visoko obrazovanje, dok za kandidate koji su završili školovanje van zemlje kopija nostrifikovane diplome;
- Dokaze za ostale kvalifikacije;
- Izvod rođenih / ekstrakt rođenih;
- Potvrda iz suda da nije kažnjavan i nije pod istragom;
- kopija lične karte ili pasoša.
- Jedna fotografija veličine (5 x 5);
- Dokumentacija iz tačke c) i d) treba da su važeće i da su izdate nakon datuma objavljivanja konkursa.

E. Opšti zadaci i ovlašćenja Policije

- Da zaštiti život, imovinu i da pruži zaštitu za sve građane;
- Da zaštiti osnovna ljudska prava za sve građane;
- Da sprečava rizik nad građanima i da održava javni red i mir;
- Da sprečava i otkrije krivična dela i njihove počinioce;
- Da istražuje krivična dela i njihove počinioce;
- Da nadgleda i kontroliše bezbednost u saobraćaju;
- Da menadžira i kontroliše državnu granicu;
- Da pruža pomoć tokom prirodnih nezgoda i u drugim emergentnim situacijama;
- Da obavlja druge poslove predviđene Zakonom o Policiji.

F. Primenjivanje odluke od 27.10.2021 pod br ref: 01/0847 za sprovođenje posebnih privremenih afirmativnih mera

Na ovom konkursu Policia Kosova preduzeće posebne privremene afirmativne mere u cilju garantovanja jednakih rodniha prava, promovisanje rodne ravnopravnosti i sa ciljem povećanja zastupljenosti policijskih službenica žena u Policiji Kosova.

Posebne mere koje će preduzeti Policia Kosova sprovođiće se u proceduri regrutacije i zapošljavanja u Policiji Kosova, na načinu da tokom procesa regrutacije policijskih službenika od svih tih kandidata koji će ispuniti uslove i prelaze prag polaganja 70% imaće prednost ženski rod.

Apliciranje za policijske službenike vrši se online. Zainteresovani kandidati mogu aplicirati putem službene veb stranice Policije Kosova: www.kosovopolice.com od **28.10.2021** do **16.11.2021**.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na brojeve telefona: 038-5080 lokal: 1554 ili 1722, kao i na tel: 038/245-184, od 09:00-15:00h.

Uspešni izabrani kandidati biće pozvani da učestvuju na gore navedenim testiranjima. Informisanje kandidata u vezi svake faze testiranja objaviće se na službenoj veb stranici Policije Kosova, na adresi: www.kosovopolice.com i na oglasnoj tabli po Regionalnim Direkcijama i odgovarajućim Policijskim Stanicama.

“Policia Kosova služi celom narodu Kosova. Ova služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Republike Kosova i očekuje aplikacije od osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu”.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Matrix Digital" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810084129.

► Liridon Buqah shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Arben Tanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren.

► Ibadete Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

► Arjeta Mullatahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X-XI dhe XII, të gjimnazit "Hajdar Dushi".

► "Caol Briquette Company" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71311023 si dhe me nr. fis. 601673545.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

